



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 434/1 Prot.

Tiranë, më 19 . 03 . 2024

V E N D I M

Nr. 73, Datë 19 . 03 . 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 37 Regj., datë 12.03.2024, të z. P. M, kundër Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*racës*”³.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar formularit të ankesës së depozituar pranë KMD-së, tek shpjegimi i fakteve për diskriminimin e pretenduar, subjekti ankues, z. P. M, parashtron se zotëron një mjet motorik pa dokumentacion përkatës, me të cilin punonte për të siguruar të ardhura për familjen.

Ankuesi shpjegon se, me datë 11.12.2023, është ndaluar nga policia, e cila i ka sekuestruar mjetin. Ndër të tjera, në ankesë citohet se: “*Unë i përkas komunitetit rom dhe ne jemi njerëz pa shkollë. Nuk e dimë se çfarë procedurash duhen për të regjistruar mjetin, plus që nuk kam mundësi ekonomike që të ndjek këto procedura që kërkohen. Policia jo vetëm që më sekuestroi mjetin me të cilin unë punoj, por e dërgojnë çështjen në gjykatë për të më dënuar. Kërkoj të më lihet i lirë mjeti me të cilin siguroj të ardhura për familjen, sepse është pronë e imja. Situata ime ekonomike mendoj se kërkon një trajtim më të butë të çështjes. Kjo situatë është bërë shqetësuese pasi është e përsëritur disa herë dhe nuk na është dhënë zgjidhje, dhe*

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Subjekti ankues vetëdeklarohet si anëtar i pakicës kombëtare rome.

unë mendoj se është diskriminim që na bëhet, pasi ata nuk duan të na shohin të qarkullojmë me mjetet tona të modifikuara në qytet sepse iu prishim imazhin e qytetit, ndërkohë që ne jemi në kushte të mjerueshme jetese dhe pa të ardhura financiare.”

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhbllokimin e mjetit me të cilin ai punon.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga këqyrja e dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, Komisioneri vëren se:

Referuar procesverbalit të datës 11.12.2023, të mbajtur nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, i cili është firmosur edhe nga ankuesi, evidentohen rrethanat si më poshtë citohet:

“Me datë 11.12.2023, rreth orës 17:00, filloi procedimi në gjendje të lirë për veprën penale “Drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt, pa lejedrejtimi, i shtetasit P. M, pasi ky shtetas me datë 11.12.2023, rreth orës 15:40 minuta ka qenë duke drejtuar mjetin motor tip “Lifan”, i modifikuar triçikël, me fuqi motorike 97 cc, pa targa, me ngjyrë të zezë, i papajisur me lejedrejtimi, në vendin e quajtur sheshi “Demokracia”, Shkodër, është konstatuar nga shërbimet e Policisë Rrugore, ku i kanë kërkuar dokumentacionin e mjetit dhe lejen e drejtimit dhe pas kontrollit ky drejtues motomjeti ka rezultuar i papajisur me lejedrejtimi dhe në këto kushte është shoqëruar për në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër për të deklaruar në lidhje me ngjarjen.”

Lidhur me sa më sipër, oficeri i Policisë Gjyqësore ka vendosur të sekuestrojë në cilësinë e provës materiale, motorin tip “Lifan”, i modifikuar triçikël, pa targa, me ngjyrë të zezë, me drejtues shtetasin P. M, i cili u la në ruajtje në ambientet e Repartit FNSH Shkodër.

Për sa më sipër, bazuar në materialin referues të dërguar nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (në vijim referuar si Prokuroria) ka regjistruar procedimin penal me nr. 1562, të vitit 2023, për veprën penale “Drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291, i Kodit Penal.

Nëpërmjet shkresës me nr. 319/1 prot., datë 15.01.2024, Prokuroria, ka përcjellë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, lidhur me procedimin penal me nr. 1562/2023, për veprën penale “Drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291, i Kodit Penal.

Në kërkesën e organit të Prokurorisë drejtuar Gjykatës, ndër të tjera citohet se:

“Është pyetur shtetasi P. M, i cili ka deklaruar se është ndaluar nga Policia Rrugore pasi ka qenë duke qarkulluar me motomjetin tip “Lifan”, triçikël i modifikuar. Ai është shprehur se nuk është i pajisur me lejedrejtimi të asnjë kategorie.

Është bërë këqyrje e motomjetit tip “Lifan”, pa targë, ku nga procesverbali i këqyrjes së bërë, rezulton se motomjeti është me fuqi motorike 97 cc dhe bazuar në nenin 53, të ligjit 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, kategorizohet si motomjet, për drejtimin e të cilit, në bazë të nenit 115 dhe 123, të Kodit Rrugor, të ndryshuar, kërkohet pajisja me lejedrejtimi e kategorisë A1 ose B, me kusht që drejtuesi i motomjetit të ketë mbushur moshën 21 vjeç (z. M është i datëlindjes 31.12.1981).

...nga të gjitha të dhënat hetimore, rezulton se, shtetasi P. M ka konsumuar tërësisht elementët e veprës penale të “Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291, i Kodit Penal, i cili parashikon se:

“Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara në gjendje të dehur, nën efektin e lëndëve narkotike apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet.

Gjykata mund të vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit.”

Objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj, për të garantuar rendin dhe sigurinë publike, e konkretisht të rregullave të qarkullimit rrugor.

Në rastin konkret, z. M me veprimet aktive të tij duke drejtuar e qarkulluar me motomjetin pa dëshminë përkatëse të aftësisë, ka cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj, për të siguruar qarkullimin e rregullt rrugor të automjeteve të tjera të motorizuara, nëpërmjet drejtimit të tyre konform rregullave të Kodit Rrugor.

Në përfundim të hetimeve paraprake, pas analizës të të dhënave dhe akteve provuese të administruara, hetimet janë të plota dhe të dhënat e grumbulluara provojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se shtetasi P. M ka konsumuar tërësisht elementët e veprës penale të “Drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar ne nenin 291, të Kodit Penal, dhe lidhur me këtë kërkohet, dërgimi për gjykim i çështjes penale me nr. 1562/2023, në ngarkim të të pandehurit P. M, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar ne nenin 291, të Kodit Penal.”

Në analizë të gjithë sa më sipër, Komisioneri vëren se:

Kodi Penal, në nenin 1⁴, të tij, parashikon se: “Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi.”

Neni 148, pika 1, e Kushtetutës së Shqipërisë, përcakton se: “Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit...”

Neni 291, i Kodit Penal, parashikon se: “Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara në gjendje të dehur, nën efektin e lëndëve narkotike apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet.

Neni 291, i Kodit Penal është një dispozitë e karakterit blanket, që referon në dispozita të tjera ligjore, prandaj, për të dhënë kuptimin e këtij neni, duhet t’i referohemi Kodit Rrugor, miratuar me ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

Qarkullimi i mjeteve motorike në rrugë rregullohet sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në nenin 72, pika 1 të Kodit Rrugor përcaktohet se: “Ciklomotorrët, motomjetet dhe automjetet duhet të jenë të pajisura me: sistem drejtimi, sistem frenimi, sistemin e sinjaleve pamore dhe ndriçuese, sistemin zhurmëmbytës dhe të shkarkimit, në qoftë se kanë motor me

⁴ “Ligji penal dhe ndarja e veprave penale”

djegje të brendshme, sistemin e sinjalizimit zanor, sistemin e shikimit prapa dhe gomat ose sistemin ekuivalent me to”.

Në nenin 78/4, të Kodit Rrugor përcaktohet se: *“Cilido që qarkullon me një mjet, i cili ka ndryshime në karakteristikat konstruktive dhe funksionale të përcaktuara, ose qarkullon me sistemet e përmendura në nenin 72, që nuk funksionojnë apo që nuk janë instaluar siç duhet, ndëshkohen me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në dhjetë mijë lekë dhe zbatohet masa administrative plotësuese e bllokimit të mjetit deri në plotësimin e kërkesave teknike e funksionale”.*

Në nenin 115⁵, pikat 1 dhe 3, të këtij Kodi, përcaktohet se: *“1. Ndalohet drejtimi i automjeteve dhe motomjeteve pa marrë lejedrejtimi, të parashikuar nga ky Kod.*

.....

Lejedrejtimi, sipas modelit të Bashkimit Evropian, siç përcaktohet me vendim të Këshillit Ministrave, ndahet sipas kategorive dhe aftësive në drejtimin e mjeteve, të përcaktuara për secilën nga kategoritë e përcaktuara në këtë Kod.”

Në nenin 119 të po këtij Kodi, përcaktohet se: *“Lejedrejtimi i mjetit merret pas provës së kontrollit të njohurive teorike dhe pas provës së verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes...”*

Në VKM nr. 153, datë 07.04.2000 *“Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”*, në nenin 311 *“Kërkesat dhe procedurat për marrjen e lejedrejtimit të mjetit”*, përcaktohet se: *“1. Për marrjen e lejedrejtimit, personi i interesuar duhet: ...të fitojë provën e kontrollit të njohurive teorike me rezultat pozitiv..., të fitojë provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes me rezultat pozitiv...nëse personi i interesuar fiton provën e verifikimit të aftësive drejtuese dhe sjelljes dhe dokumentacioni është i plotë, sektori përkatës i DRSHTRR-së e pajis atë me lejedrejtimi, për kategorinë e kërkuar...”*

Bazuar në sa më sipër dhe dokumentacionin e depozituar (procesverbalet e mbajtur dhe kërkesa e Prokurorisë drejtuar Gjykatës), lidhur me pretendimin e ankuesit për sekuestrimin e mjetit të tij triçikël i modifikuar, nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, Komisioneri vëren se, të gjitha këto pretendime janë bërë pjesë e hetimit dhe shqyrtimit të organeve kompetente të drejtësisë, si prokurori e gjykatë, dhe kjo e fundit aktualisht është në proces gjykimi të çështjes në fjalë.

Në këtë kontekst, bazuar në sa më lart, Komisioneri nuk ka tagër e kompetencë ligjore për hetimin, shqyrtimin e vlerësimin e pretendimeve të tilla që apriori mund të përbëjnë elementë të veprave penale, që hetohen e janë objekt i punës së organeve respektive të drejtësisë.

Për rrjedhojë dhe shqyrtimi i tyre është jashtë kompetencave të KMD-së, dhe për pasojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

⁵ Kategoritë e lejedrejtimit për drejtimin e motomjeteve dhe automjeteve.

Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁶, të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”

Mungesa e kompetencës së Komisionerit për shqyrtimin e këtyre pretendimeve të paraqitura nga ankuesi, e bën ankesën lidhur me këto kërkitime, të papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me nr. 37 Regj., datë 12.03.2024, të subjektit ankues P. M, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁶ Nga praktika e KMD-së, për analogji citojmë vendimin nr. 12, datë 29.01.2015, të KMD-së.

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë , Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al